



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptanit", nr.2, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr.206/ Prot.

Tiranë, më 12.08.2019

**V E N D I M**

**Nr. 47, Datë 12.08.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-T QARKU LEZHË (DREJTORIA VENDORE E AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS LEZHË) "MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE" për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë) rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mangësive proceduriale në zbatimin e ligjshmërisë dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm si dhe Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale" të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Lezhë, sot Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të**

Kadastrës Lezhë, sipas programit të auditimit nr. 206/1, datë 01.04.2019, për veprimtarinë ekonomiko financiare nga data nga 01.01.2017 deri në 31.12.2018.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

### ***Konkluzioni dhe Opinion i Auditimit***

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë), në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe (ISSAI 4100<sup>1</sup>) për të cilën do të japim opinion:

-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,250,814 lekë,

- Për 2538 leje legalizimi të lëshuara dhe dërguar në ZVRPP për regjistrim të objektit informal për periudhën objekt auditimi në momentin e auditimit nuk ka VKM për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objektit të legalizuar duke sjellë mos llogaritjen e detyrimit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore dhe krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimin e ish pronarëve në shumën 1,625,592mijë lekë,

- Në 7 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, madje është cënuar trupi i rrugës ku sipas Gen Planit të administruar në dosje rezulton se objektet bien mbi rrugë a trotuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përfundimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku në ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”

-VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në 8 rast është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, germat: “dh”;

-Në 26 raste me sipërfaqe prej 8714 m<sup>2</sup>, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr.

<sup>1</sup> ISSAI 4100 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.

9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” -Në 7 raste objektet e legalizuara janë aktualisht brenda zonës së mbrojtur të Kune – Vain - Tale veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe, VKM me Nr.432, datë 28.4.2010, “Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale;

- Në 3 raste objektet janë dhënë për objekt poshtë linjës së tensionit të lartë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 54 pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe Vendim Këshillit Të Ministrave Nr. 280, datë 1.4.2015, (I ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016), “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kapitulli II, pika 2 “ç”.

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë), nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të kualifikuar me rezerve**<sup>2</sup>.*

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** -Në 22 rastet “Procesverbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti deri në kufirin e pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve, etj. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri) (Trajtuar më hollësisht në faqet 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë të marrë masa për 22 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “Procesverbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës së ndërtimit, në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit të këtyre kërkesave, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe t’i kërkojnë Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur në ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën”, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave

<sup>2</sup>“Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit”

informale”, i ndryshuar e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij për periudhën referuese dhe që ka qenë në fuqi.

*Deri më datë 30.10.2019*

**2. Gjetje nga auditimi:** - Në 4 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë) nuk është respektuar **afati 60 ditor** për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, ndërkohë që **në 2 raste** nuk është respektuar **afati 30 ditor** për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim me: pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 i ndryshuar “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar, pika 2 e VKM nr.954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” me ndryshime *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërish, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë dhe rritur transparencën për publikun.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –**“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”**. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë bashkive të Qarkut Lezhë, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për **3100 objekte informale** dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,250,814 lekë** *(Trajtuar më hollësisht në faqen 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në **vlerën prej 42,250,814 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës** në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, **në refuzim të vendosën masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

*Brenda muajt Dhjetor 2019*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.12.2018 janë lëshuar **4770 leje legalizimi** për objektet informale të legalizuara. Nga **4770 leje legalizimi të lëshuara, 2538 leje legalizimi** ose rreth 50 % e këtyre lejeve të legalizimit (4770) janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit **“Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”** referuar V.K.M. nr.954, datë 25.11.2015 dhe V.K.M. 1095, datë 28.12.2015”. Për 2443 leje legalizimi nuk është arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore në vlerë 800,917,000 lekë dhe 796,321,000 bono privatizimi. Veprim në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 ( pika 5 ) *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

-të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **2443 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës së parcelave ndërtimore në shumën prej 800,917,000 lekë dhe 796,321,000 bono privatizimi.

### **Brenda muajit Dhjetor 2019**

**5. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë) për periudhën objekt auditimi ka lëshuar gjithsej 4770 leje legalizimi për objekte informale, ndërsa sipas të dhënave konstatohet se periodikisht brenda periudhës objekt auditimi, kanë dalë nga arkiva e institucionit për tu punuar *4418 dosje* të objekteve informale, për të cilat është kryer edhe kualifikimi i objekteve informale për të vazhduar procedurat deri në lëshimin e lejes së legalizimit, ndërkohë *për të njëjtën periudhë janë kryer matjet në terren për 3752 objekte informate. Për 352 leje të lëshuar, nuk është përcaktuar afati i matjeve në terren si dhe nuk kanë të evidentuar respektimin e afateve ligjore për kualifikimin e objekteve informale*, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27, 28 si dhe VKM nr.589, datë 10.09.2014, pika 10 i ndryshuar me VKM nr.634, datë 7.9.2016 si dhe VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu i IV, pika (8) , si dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015 pika 2, si dhe me nenin 15 pika 4 e Rregullores me nr.117, datë 14.07.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, për **352 objekte informale** të pajisur me leje legalizimi të evidentojë respektimin e afateve të matjeve ne terren, kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit, si dhe për objektet informale për të cilat kanë përfunduar evidentimin faktik në terren të ndërtimeve pa leje, evidentimi i gjendjes juridike të truallit, si dhe hartimi i genplanit dhe planimetrive, por pa përfunduar procesi i legalizimit. Të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit, duke i trajtuar në funksion të afatit kohor të qëndrimit në arkivë.

### **Brenda muajit Dhjetor 2019**

**6.Gjetje nga auditimi:** Në **51 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi:*

- Në **7 raste**, janë kryer legalizime të objekteve **pa respektuar distancat nga rrugët**, madje është cënuar trupi i rrugës ku sipas Gen Planit të administruar në dosje rezulton se objektet bien mbi rrugë a trotuar, **ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor.** Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përfundimi nga legalizimi” me VKM nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b, ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, VKM nr.153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2.

- Në **8 raste** është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar **në afërsi të lumit, përroi, kanal dhe digë, pa respektuar distancat e kërkuara nga brigjet.** Në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar

të burimeve ujore”, neni 84 i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, geramat: “dh”;

**-Në 26 raste me sipërfaqe prej 8714 m<sup>2</sup>**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11 e 14 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”;

**-Në 7 raste** objektet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Kune – Vain - Tale** veprim në kundërshtim me ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe, VKM me Nr.432, datë 28.4.2010, “Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale;

**- Në 3 raste** objektet janë dhënë **për objekt poshtë linjës së tensionit të lartë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 54 pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe Vendim Këshillit Të Ministrave Nr. 280, datë 1.4.2015, (I ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016), “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kapitulli II, pika 2 “ç” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 24-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Drejtësisë, **për 51 rastet e evidentuara më sipër**, ku për objektet informale të pajisura me leje legalizimi janë lidhur kontratat, **të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit** të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

*Brenda muajt Dhjetor 2019*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në DR ALUIZNI-t Qarku Lezhë mungojnë dhe nuk u paraqitën grupit të auditimit dokumente si: urdhri dhe grupi i punës, mungojnë kriteret, procedurat dhe afatet, kërkesa apo shkresa nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë për hartimin e PB bashkë me udhëzimet specifike përkatëse, krahas udhëzimeve të përgjithshme dhe gjithashtu mungojnë shkresat përcjellëse të DR ALUIZNI Lezhë të Projekt-buxheteve në shoqërim të tabelave standarde të kërkesave buxhetore të v.2017 dhe PBA v. 2017-2019; të v.2018 dhe PBA 2018-2020 (të cilat hartohen dhe dërgohen përkatësisht deri në Gusht v.2016 dhe Gusht 2017).

Kërkesat buxhetore të v. 2017 dhe v.2018, janë të pjesshme (krahasuar me nivelet e realizimeve faktike të viteve të mëparshme) që pretendohet të jenë dërguar me (e-mal datë 26.4.16, datë 19.4.17, pa shkresa përcjellëse) me disa tabela dhe shifra, pasi për v. 2017, vetëm për artikujt nr. 602 mallra e shërbime në vlerën 3460 mijë lekë nga e cila 2200 nga buxheti dhe 1260 mijë lekë nga të ardhurat. Ndërsa për v. 2018, vetëm për artikujt nr. 602 mallra e shërbime në vlerën 4948

mijë lekë nga e cila 3000 nga buxheti dhe 1948 mijë lekë nga të ardhurat, pa përcaktuar kërkesë për artikujt e tjerë, si dhe duke mos përcaktuar parashikimin e mbulimit të nevojave për buxhet me burim nga të ardhurat e vetë DRALUIZNI-t. Pra, kërkesa këto me të dhëna të pambështetura në treguesit e buxheteve arritur në v. 2016 e v.2017 apo të parashikuar për tu realizuar në v.2017, 2018 duke mos u mbështetur në “produktin kryesor” si dhe në kostot përkatëse të arritura ose parashikuara, që do të ishin: vetëdeklarimet prej 24643 objekte gjendje, 2450 legalizime të kryera në v. 2016 dhe 1913 legalizime në v.2017 apo 2857 në v. 2018 ,që mbështetur treguesit e mësipërm, do të përbënin “produktin kryesor” mbi të cilat do të llogariteshin kostot dhe nevoja për buxhet; mangësi që ka sjellë kërkesë buxhetore të v. 2017 dhe v.2018 të pjesshëme, të pa plotë, të pa argumentuara, buxhete jo funksional dhe të pa mbështetura as në përfshirjen dhe parashikimin e nivelit të ardhurave nga aktiviteti kryesor i shërbimit tarifës lejeve te legalizimit, të ardhurat nga parcelat ndërtimit, nga kamatvonesat të grupuara sipas formës së pagesës me bono e me kesh, dhe gjithashtu dhe pjesën përkatëse për shpenzime sipas përkatësisë së të ardhurave; *ekzistenca e të cilave do të përbente (produktin sipas Programeve) ku do të mbështeteshin argumentimi i PB dhe PBA reale, funksionale në përmbushje të funksioneve ligjore të DR ALUIZNI-t Lezhë*; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; me UMF nr.8, datë 29.3.2012”Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA”, me ligjin nr.147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, ligjin nr.130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018” dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” dhe Udhëzimit nr.4, datë 29.02.2016 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe sipas detajimeve të Tavaneve Buxhetore sipas tabelave Standard” pasqyruar në tabelën emërtuar “**Hartimi miratimi dhe realizimi i objektivave të buxhetit DR ALUIZNI Lezhë viti 2017 dhe 2018**“ ( *Trajtuar në faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1 Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhë), Drejtori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me ASHK Tiranë, të hartojnë Projekt buxhete PB dhe PBA, të zbatojnë procedurat ligjore në kohë, mbështetur në treguesit përcaktues të parashikuar të “Produktit Kryesor” si numri i vetëdeklarimeve, numri i lejeve të legalizimit, dhe në përfshirjen, parashikimin e nivelit të ardhurave nga aktiviteti kryesor i shërbimit tarifës lejeve të legalizimit, të ardhurat nga parcelat ndërtimit, etj., dokumente të hartuara me parë me kostot përkatëse të çdo legalizimi, pra në tregues të matshëm, me synim përgatitjen e buxheteve të plota, të argumentuara dhe funksional për realizimin misionit, funksioneve, objektivave, qëllimit dhe planveprimeve përkatës.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhë), në zbatimin ndjekjen menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit për veprimtarinë e viteve 2017 dhe 2018, ka parashikime me rezerva, buxhete të pa argumentuar jo real funksional dhe mosrealizime përkatësisht: në vitin 2017 realizuar 97,8%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **37,370** mijë lekë kundrejt planit **38,176** mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej **-807** mijë lekë, kryesisht në artikullin paga dhe sigurime shoqërore (nga mos parashikimi i saktë), dhe në artikullin mallra e shërbime. Në vitin 2018 buxheti i realizuar 97,2%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **28,848** mijë lekë kundrejt planit **29,682** mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej **-834** mijë lekë kryesisht në artikullin paga (nga parashikimi me rezerva) dhe në artikullin mallra e shërbime. Sipas burimeve mosrealizimet kanë ardhur nga burimi i financimit prej të ardhurave; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” në mosrespektim të kriterit rritjes, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, si dhe me ligjin nr. 130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”,

ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, sikundër pasqyruar në kolonat 6, 7, 8, 9 të tabelës emërtuar “**Hartimi miratimi dhe realizimi i objektivave të buxhetit DR ALUIZNI Lezhë viti 2017 dhe 2018**“(Trajtuar hollësisht në faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandim:** Drejtoria Vendore Lezhë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (për ish-DRALUIZNI-t Lezhe), Drejtori, me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa të vazhdueshme për menaxhimin dhe ndjekjen e treguesve ekonomik dhe financiar të zbatimit të Buxhetit periodik e vjetor dhe në situata mosrealizimi, apo pamjaftueshmërie të marrë masa në kohën e duhur për ndryshimet përkatëse në zbatim të procedurave sipas nenit 45 të ligjit të ligjin nr.9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, me synim shmangien e mospërdorimit apo të pamjaftueshmërisë dhe të pasojës në mos përmbushjen e objektivave të institucionit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** DR ALUIZNI-t Lezhë për v.2017 dhe 2018 lidhur me evidentimin, mbledhjen e të ardhurave në lekë dhe në bono privatizimi, apo lëvizjes së aktiveve **nga transferimi i pronës dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje**, nuk kanë ndjekur, pasqyruar saktë dhe regjistruar veprimet në ditarin e bankës së të ardhurave, në hartimin, regjistrimin, korespondimin dhe administrimin e dokumentacionit justifikues, nga mungesa e koordinimit ndërmjet sektorit të financës me sektorin e legalizimeve lidhur me rakordimin, identifikimin e numrit të lejeve të legalizimit dhe të ardhurave që duhen mbledhur nga lëshimi i tyre, që ka sjellë si pasojë që në ditarin e bankës dokumentohen për v. 2017 vetëm **759 persona** kundrejt **1913 lejeve** legalizimi të raportuara si të lëshuara dhe në **785 kundrejt 2857 lejeve** të raportuar të lëshuara v. 2018, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Kreu I-rë, neni 3, pika 8 , germa “c”, Kreun II, neni 6, pika 2, Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim“, UMF nr. 30, datë 29.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; pasqyruar në tabelën emërtuar “*Arkëtimet mujore dhe vjetore të ardhurave nga legalizimet, sipas Ditarit bankës, numri dhe rakordimet me thesarin për vitet 2017 dhe 2018*”, bashkëlidhur si pjesë e aktkonstatimit (Trajtuar në faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandim :** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhe), Drejtori me strukturat përkatëse, sektori i financës në bashkëpunim me sektorin e legalizimeve, të marrin masa dhe të:

1. Të identifikojnë, inventarizojnë dhe rakordojnë të dhënat duke listuar lejet e legalizimit sipas nr. e datës dhe emrit të personave që i përkasin vitit 2017 për **759 persona të regjistruar në ditar** dhe për secilin leje-person të totalit prej **1913 lejeve** legalizimi të raportuara si të lëshuara dhe për vitin 2018 për **785 persona të regjistruar në ditar** secilin leje-person të totalit prej **2857 lejeve** të raportuar të lëshuara vitin 2018, si dhe për këtë të bejnë llogaritjet për detyrimin e të ardhurave eventuale pasi të hartojnë dokumentacionin me faturat përkatëse, duke përputhur kështu të dhënat regjistruar në regjistrat ditarë të Financës me të dhënat e raportuara sipas numrit të lejeve nga Sektori i legalizimeve

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**9.2 Rekomandim :** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, sektori i financës dhe sektori i legalizimeve të rakordojnë dokumentacionin dhe raportojnë të ardhurat për



buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë çdo fund muaji, 3/mujor e çdo vit mbështetur në identifikimin e numrit dhe të datës së lejes së legalizimit, emër mbiemër të personit (dhe jo vetëm identifikimi personi, pasi i njëjti person zotëron mbi një e më shumë objekte apo leje) në mbajtjen e ditarit të përshkruhet, vendoset në korrespondencë, përveç identifikimit të lejes legalizimit, dokumentet justifikues faturat autorizimet, shkresat ndaj NJQVV-ve, lëshuar personave përfitues të lejeve të legalizimit. Kjo me synim bashkërendimin ndërmjet sektorëve, vendosjen e funksionimit të sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në administrimin hartimin dhe qarkullimin e dokumentacionit të lëvizjes së aktiveve që përbejnë të ardhura për buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë, por edhe evidentimin, identifikimin e barrëve mbi pasuritë (me origjinë nga legalizimet) në procesin e mëvonshëm të regjistrimit të pasurive të legalizuara ,në përmbushje të kërkesave të ligjit “Për Kadastrën”.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**9.3. Rekomandim:** Të hartohet rregullore për vendosjen e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) duke përcaktuar strukturat personat përgjegjës detyrat afatet, lidhur me hartimin ndjekjen e faturave të detyrimeve për çdo leje legalizimi të lëshuar, shlyerjen e detyrimeve, ndjekjen dhe evidentimin e detyrimeve të papaguara ose që nuk kanë plotësuar afatin e likuidimit, me synim administrimin e të ardhurave nga për buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë, por edhe evidentimin, identifikimin e barrëve mbi pasurin (me origjinë nga legalizimet) në procesin e mëvonshëm të regjistrimit të pasurive të legalizuara, në përmbushje dhe harmonizim të kërkesave të ligjit “Për Kadastrën”.

*Deri në muajin Dhjetor 2019*

**10. Gjetje nga auditimi:** ALUIZNI-i Lezhë, sektori financës, për vitin 2017 dhe 2018 nuk e ka mbajtur, plotësuar në formatin ligjor përkatës, Ditarin e Bankës së të Ardhurave, i cili ka mangësi në kolonat “nr.Referimi”, pa korrespondencë të nr. dhe dokumentacionit , “Përshkrimi”, **nuk përmban asnjë përshkrim veprimi**. Pra nuk pasqyrohen qartë dhe objektivisht regjistrimet kontabile për lëvizjen e aktiveve në lekë e në bono të hyra nga procesi i legalizimit, ka mosrakordim për 12.650 lekë në vitin 2017 dhe për 88.300 lekë për vitin 2018 të shumave të regjistruara ndërmjet debitimeve në Llogarinë 520 dhe shumave të kredituara në llogaritë përkatëse të klasës 7 të të ardhurave nga legalizimet, ditari është i pa mbledhur dhe pa hedhur shifrat të mbartura progresivisht dhe periodikisht për çdo muaj, 3/mujor dhe si vjetor, dhe nga verifikimi aritmetik rezulton se regjistrimet në disa raste janë jo të barabarta për shumat në debi të Bankës llogaria 520 me shumat regjistruar në kredi të llogarive të klasa 7. Megjithëse shumat mujore shkruhen si të barabarta;dhe regjistrime të parregullta si në 93 raste në v.2017 dhe 62 raste në v.2018 ka kryer regjistrime (të grupuara nga 2 deri në 12 tarifa 8000 lekëshe) të tarfiave të shërbimit, për emra personash në shmangie e mos referencë të numrit të lejes legalizimit apo dhe evidentimit të raste-personave mbajtës të mbi dy lejeve të legalizimit me pasojë risku në të ardhurat; në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Kreu I-rë, neni 3, pika 8 , germa “c”, Kreun II, neni 6, pika 2, Ligji nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje “, i ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim“, UMF nr.30, datë 29.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; pasqyruar në tabelën emërtuar “Arkëtimet Mujore dhe vjetore të Ardhurave nga Legalizimet, sipas Ditarit Bankës, numri dhe rakordimet me thesarin për vitet 2017 dhe 2018” (Trajtuar në faqet 89-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhë), Drejtori, sektori i financës marrë masa të çelë, mbajë në formatin ligjor të kërkuar Ditarin e Bankës për të ardhurat e arkëtuara dhe detyrimet e papaguara, nga legalizimet e ndërtimeve informate si dhe të regjistroj kronologjikisht veprimet dhe ngjarjet, mbështetur rakordimet periodike (mujore 3/mujore vjetore) me sektorin e legalizimeve për (produktin apo shërbimin nëpërmjet dokumentacionit), duke identifikuar, përfshirë, përshkruar e vene në korrespondencë numrin, datën e lejes legalizimit, emër mbiemër të personit mbajtës të lejes, së cilës i korrespondojnë faturat, autorizimet e pagesave, por sidomos edhe shkresat njoftuese drejtuar NJQVV-ve për vlerën e detyrimit në lekë të taksës së infrastrukturës, etj., me synim administrimin e mbledhjes të ardhurave evidentimin e barrëve mbi titujt e pronësisë përfituar nga legalizimi, saktësinë në procesin pasues të regjistrimit dhe çeljes së KPP të pasurisë, nga Agjencia Shtetërore Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë; konforme ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”,

*Menjëherë*

**10.2. Rekomandim:** Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DRALUIZNI-t Lezhë), Drejtori, sektori i financës me sektorin e Legalizimeve të marrin masa të krijojnë Database të lejeve të legalizimit, Sektori i financës të përfshijë dhe regjistroje në Ditarin e të ardhurave apo çelë ditar tjetër për të gjitha lejet e legalizimeve të lëshuara, pa kundërpagesa nga përjashtimet ligjore apo përfitimet falas, ku të përshkruajë dokumentet justifikues, me synim qartësinë dhe saktësinë e evidencës kontabile, Ditarit, dhe bërjen të mundur vendosjen e sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB) në qarkullimin dhe dokumentimin aktiveve të ardhura nga procesi i legalizimeve) dhe rritjen e transparencës së punës së zyrës.

*Menjëherë dhe vazhdimisht*

**11Gjetje:** DR ALUIZNI-i Lezhë, sektori financës, për secilin prej viteve 2017 dhe 2018 nuk ka asnjë rakordim vjetor dhe periodik me Credins Bank lidhur me arkëtimet me bono thesari të pagesave për parcelat ndërtimore përkatësisht: për **132 raste me 23.955.000 lekë** vlerë bono për v.2017 dhe për **160 raste me vlerë 31.065.000 lekë** vlerë bono për v.2018, pasqyruar në Ditarin përkatës, megjithëse lejet e legalizimeve janë lëshuar e posedohen nga mbajtësit, vlera të cilat përbejnë gati mbi 50 % të vlerës totale të të ardhurave nga transferimi i pronave dhe legalizimeve të ndërtimeve pa leje (*Trajtuar në faqet 89-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandim:** Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DRALUIZNI-t Lezhë), sektori i financës, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve periodike mujore e vjetore në vazhdimësi me Credins Bank dhe lidhur me arkëtimet me bono thesari të pagesave për parcelat ndërtimore përkatësisht: për **132 raste me 23.955.000 lekë** vlerë bono për vitin 2017 dhe për **160 raste me vlerë 31.065.000 lekë** vlerë bono për vitin 2018 të regjistruara në ditarët e bankës së të ardhurave .

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga ALUIZNI Lezhë, sektori i financës dhe sektori i legalizimeve (në cilësinë e autoritetit ligjor të prodhimit të dokumentacionit të legalizimeve të objekteve) për secilin prej viteve 2017 dhe 2018, nuk ka asnjë evidence debitorësh dhe asnjë rakordim me NJQVV-të si; Bashkinë Lezhë, Mirditë, Kurbin lidhur me arkëtimin shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga pagesa e tarifës ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara nga ndërtimet informale, ekzistenca e të cilës do të ndihmonte saktësinë e procesit pasues të regjistrimit dhe çeljes së KPP të pasurisë, por dhe pasqyrimin e gjendjes juridike, nga Drejtoria Vendore Agjencia Shtetërore Kadastrës Lezhë konform ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, pasqyruar në kolonën nr.12 të tabelës emërtuar “Arkëtimet mujore dhe vjetore të ardhurave nga legalizimet, sipas Ditarit Bankës,

*numri dhe rakordimet me thesarin për vitet 2017 dhe 2018” (Trajtuar në faqet 89-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhë), Sektori i financës, Sektori i Legalizimeve dhe Sektori Regjistrimit (në cilësinë e autoritetit ligjor të prodhimit të dokumentacionit të legalizimeve të objekteve informale) të marrin masa për secilin prej viteve 2017 dhe 2018 dhe prej fillimit të procesit të rakordojnë nxjerrin evidence me NJQVV-të; Bashkinë Lezhë, Mirditë Kurbin lidhur me arkëtimin shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga pagesa e tarifës ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara nga ndërtimet informale, ekzistenca e të cilës do të ndihmonte saktësinë e procesit pasues të regjistrimit dhe çeljes së KPP të pasurisë por dhe pasqyrimin e gjendjes juridike, nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore Kadastrës, Lezhë.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë (DR ALUIZNI-t Lezhë), sektori financës për vitin 2017 nuk ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve për vitin 2017, (por është mjaftuar me inventarizim kryer në muajin Gusht për shkak të transferimit të zyrave), ndërsa për vitin 2018 pas kryerjes së inventarizimit fizik të aktiveve nga ana e sektorit financës nuk janë vazhduar me procedurat, për nxjerrjen jashtë përdorimit të 14 artikujt me vlerë 1,134,652 lekë, megjithëse kanë kaluar 2 muaj nga miratimi me shkresën nr.10168/1, datë 31.12.2018 (mbërritur datë 05.03.2018) i Drejtorisë Përgjithshme të Aluizni-t Tiranë sipas dokumentacionit paraqitur nga DR ALUIZNI Lezhë, shkresa nr.5335, datë 31.12.2018, Urdhri nr.26, datë 31.12.2018 dhe Relacioni i vlerësimit drejtuar Drejtorisë Përgjithshme ALUIZNI –t (Degës Financës); mosveprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 29.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, si dhe gjithashtu për të dy vitet 2017 dhe 2018, komisionet e inventarizimit kanë në përbërje të njëjtët persona si për inventarizimin e Gushtit 2017 ashtu dhe për inventarizimin fizik 2018 , veprim në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011(*Trajtuar në faqet 89-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandim:** Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, (për ish-DR ALUIZNI-t Lezhë), Drejtori në cilësinë e Nënpunësit Autorizues , Sektori i Financës, të marrin masa për vazhdimin e procedurave ligjore, vonuar prej 2 muajsh, për nxjerrjen jashtë përdorimit të 14 artikujt me vlerë 1.134.652 lekë, të rezultuara nga inventarizimi fizik i aktiveve v.2018, të propozuara e miratuara me shkresën nr. 10168/1, datë 31.12.2018 (mbërritur datë 05.03.2018) të drejtorisë Përgjithshme ALUIZNI Tiranë sipas dokumentacionit paraqitur nga DR ALUIZNI Lezhë, shkresa nr.5335, datë 31.12.2018 , Urdhri nr.26, datë 31.12.2018 dhe Relacioni i vlerësimit drejtuar Drejtorisë Përgjithshme ALUIZNI (Degës Financës).

*Menjëherë*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë), në organizimin procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore pasi:

- Nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla të DR ALUIZNI Lezhë nuk janë krijuar dosje/praktikë e mirëfilltë dokumentare për çdo procedurë prokurimi, dokumentacioni administrohet bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, ndërkohë që pjesa dërrmuese e dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim, janë të pa inventarizuara, dhe të pa listuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në te gjitha raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nuk ka kërkuar llojin i markës (pra specifikim në çdo artikull) pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5, në procedurat:

- Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në **6 raste** në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, ka shpallur fitues operatorët ekonomikë edhe kur nuk kanë plotësuar specifikimet e kërkuara në ftesën për ofertë, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” si dhe Udhëzimin nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr.1, datë 28.02.2014, Udhëzimin Nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr.1, datë 21.04.2016.

- Në vitin 2017 nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime. Mos hartimi i kërkesave nga njësitë apo zyrat përkatëse bie në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, neni 40 si dhe UMF, nr.33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”,

- Në te gjitha raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 5,973,437 lekë, nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit, si dhe në **8 raste** mungon relacioni apo procesverbali konstatues nga personat kompetent dhe nga Ssektori i financës, për nevojën për mallra, punë dhe shërbime, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, neni 59 dhe UMF, nr.33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” ndryshuar.

- Procedurat e prokurimit te hedhura në sistemin elektronik nuk janë të rregullta pasi nuk janë hedhur njoftimet për shkualifikimin dhe shpalljen fitues në rastet kur operatorët e radhës kanë hequr dorë nga konkurrimi, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr.5, date 21.1.2015 me ndryshime dhe për vitin 2018, me nr. 3, date 8.1.2018. Udhëzimit nr. 4, datë 04.07.2013 i ndryshuar

Në vitin 2017 për prokurimet me vlerë të vogël, me vlerë totale 3,706,962 lekë nuk është ngritur Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Mallit, mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, si dhe ne disa raste faturat tatimore apo fletë hyrjet nuk janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse, në disa raste faturat tatimore nuk janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e e komisioni te blerjeve te vogla, në disa raste dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me fletë garanci, veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 14, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX , Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, pika 45.

-Për periudhën e audituar ne 4praktika janë kryer veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 date 8.1.2018 “për blerjet e vogla” pika 14, germa b), anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël do të refuzojnë automatikisht ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky autoritet gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Ky proces do të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

- Për blerjet e vogla të kryera në rruge elektronike nga muaji Maj 2018, deri ne 30.12.2018, janë kryer në kundërshtim me udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “mbi përdorimin e procedurës së

prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar në udhëzimin nr.11 datë 30.05.2018 për blerjet e vogla 2. Pika 6.

- Për sa i përket dokumentacionit bashkëlidhur procedurave për likuidim ne banke rezultoi se: nuk janë bashkëlidhur të gjithë dokumentacioni justifikues veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin”, “Udhëzimin nr.30 date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, mangësi që kanë sjelle si pasojë mos justifikim me dokumente të plota të kryerjes së shpenzimit të përmendura me sipër, si dhe në kundërshtim të kreut I neni 3 pika 8 germa c) kreu II neni 6 pika 2 te ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare nr. 9228 date 29.04.2004 dhe në kundërshtim ligjin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 98-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, të marrë masa, për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të kryet inventari i dokumentacionit shoqërues, në ftesat për ofertë të përcaktohen specifikimet teknike, të hartohet relacioni konstatues, në çdo rast të hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit me specifikime të sakta shoqëruar me faturën tatimore, në urdhër prokurimit nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret.

*Në vijimësi*

## **B. MASA DISIPLINORE**

**I.** Mbështetur në nenin 15/c të ligjit 154/2014 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”; Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në baze të nenit 9, pika 2, germa ç te ligjit nr. 111/2018, date 7.2.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, **t’i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me paralajmërim”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për këta punonjës:

1. z. A. M. me detyrë Përgjegjës Sektori
2. znj. N.N me detyrë specialiste financës (me cilësinë e komisionit të kryerjes së inventarizimeve vjetore sipas urdhrave nr.3315 datë 16.08.2017 për v.2017 dhe nr.22, datë 16.11.2018, për v.2018);
3. znj. O.V, me detyrë specialiste,
4. z. L.N, me detyrë specialist terreni
5. z. E. N.me detyrë specialist terreni
6. z. E.N.me detyrë specialist terreni
7. z. R. B. me detyrë specialist terreni
8. z. M. P. me detyrë specialist terreni
9. z. V. C. me detyrë specialist terreni.

**II.** Për 3 punonjës aktual, nuk propozojmë masë, pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:  
A.Sh.J. P.dhe N. L.

**III.** Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional

Për **12 ish-punonjës** dhe ish drejtuesit sipas shkallës së përgjegjësive masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, nuk rekomandojmë masa disiplinore, pasi nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, përkatësisht:

1. B. N, me detyrë ish Drejtor,
2. P. L, me detyrë ish Drejtor,
3. A. M, me detyrë ish Drejtor,
4. D. P, me detyrë ish Përgjegjës Sektori,
5. V.Gj, me detyrë ish specialiste,
6. B. Ç,me detyrë ish specialiste,
7. M. Gj, me detyrë ish specialist terreni,
8. E. N,me detyrë ish specialist terreni,
9. A. Sh,me detyrë ish specialist terreni,
10. O. P, me detyrë ish specialist terreni,
11. E. S, me detyrë ish specialist terreni,
12. B. C,me detyrë ish specialist terreni.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**